



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1519/1_Prot.

Tiranë, më 16.11.2021

V E N D I M

Nr. 224 , Datë 16 .11 . 2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 196, datë 01.11.2021, të paraqitur nga ankuesi K.H kundër G.M, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe N.M, Oficer i Policisë Gjyqësore, pranë Komisariatit të Policisë Fier, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes ekonomike*” dhe “*aftësisë së kufizuar*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi K.H, ka parashtruar se, është dënuar më parë për veprën penale të vjedhjes, për të cilën ka kryer dënimin në periudhën 11 mars 2020-14 korrik 2020. Pas kryerjes së dënimit ankuesi shpjegon se është liruar me urdhrin nr.3064/1/1 date 14.07.2020. Ankuesi shpjegon se, më datë 19.05.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka nxjerrë urdhrin për burgimin e mënjëhershëm të tij, dënim për të njëjtën veprë penale për të cilën ai kishte kryer më parë dënimin. Ai deklaron se, në të tilla kushte është ushtruar kontroll personal ndaj tij në ekzekutim të urdhrin të prokurorisë dhe në bazë të procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim nuk i është gjetur asnjë gjë.

Sa më sipër ankuesi pretendon se është dënuar dy herë për të njëjtën veprë penale, për periudhën 18.06.2021 – 24.09.2021, në shkelje flagrante të të drejtave të tij. Për të njëjtën problematikë, ankuesi deklaron se ka bërë ankesë te SPAK, por ende nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Ankuesi deklaron se i është drejtuar Komisionerit, pasi ndihet i diskriminuar për shkak të gjendjes ekonomike dhe aftësisë së kufizuar dhe se dëmi moral dhe psikologjik që ka pësuar i kanë sjellë probleme të shëndetit mendor.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të tij dhe dëmshpërblim.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Bazuar në aktet e administruara rezulton se ankuesi K.H, me vendimin nr.133, datë 26.05.2020, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të “vjedhjes”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal dhe është dënuar me 6 muaj burgim. Me vendimin nr. 20, datë 17.02.2021, Gjykata e Apelit Vlorë, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi.

Pasi vendimi penal për dënimin e ankuesit K.H, ka marrë formë të prerë, me urdhrin nr.307, datë 19.05.2021, të lëshuar nga G.M, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, është urdhëruar ekzekutimi i vendimit nr.133, datë 26.05.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, burgimi i menjëhershëm i të dënuarit K.H dhe transferimi i tij në IEVP të sigurisë së zakonshme, ku të mbahet për një periudhë prej 6 muaj, afat i cili fillon ditën e ekzekutimit të vendimit. Për zbatimin e këtij urdhri është ngarkuar D.V.Policisë Fier.

Nga aktet e vendosura në dispozicion nga ankuesi rezulton se, ankuesi është ndaluar për kryerjen e veprës penale të mësipërme, në datën 11.03.2020. Më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vlerësuar si të ligjshëm arrestin në flagrancë dhe me vendimin nr.350, datë 13.03.2020 ka caktuar ndaj ankuesit, në cilësinë e të pandehurit, masën e sigurimit “arrest në burg”. Me vendimin nr.856 datë 14.07.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier në referim të nenit 261/c të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur të deklarojë shuarjen e masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj të pandehurit K.H, të dhënë me vendimin nr.350, datë 13.03.2020, duke patur parasysh faktin se kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur nga i pandehuri, deri në momentin e shpalljes së vendimit, ishte më e madhe se masa e dënimit të caktuar.

Rezulton se vendimi nr. 133, datë 26.05.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është ekzekutuar në datën 18.06.2021, fakt ky që rezulton nga procesverbali me të njëjtën datë i mbajtur nga N.M, Oficer i Policisë Gjyqësore, në Komisariatit e Policisë Fier. Sipas këtij procesverbali, rezulton se shtetasi K.H është dërguar në Dhomat e Paraburgimit të Komisariatit të Policisë Fier. Ankuesi rezulton të jetë dërguar pranë IEVP Lushnje, për vuajtjen e dënimit të dhënë ndaj tij me vendimin penal nr.133, datë 26.05.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku rezulton të ketë qëndruar deri në datën 24.09.2021. Sipas urdhër-lirimit me nr.1144/1 prot., datë 24.09.2021, të lëshuar nga IEVP Lushnje, ankuesi është liruar nga ky institucion më datë 24.09.2021. Referuar përmbajtjes së këtij urdhër-lirimi, rezulton se, pasi IEVP Lushnje ka përcjellë rezultatin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit, i cili pretendonte se e kishte kryer dënimin, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier me urdhrin e ekzekutimit nr.307/1 datë 24.09.2021 ka vendosur shfuqizimin dhe lënien pa fuqi të urdhrit nr.307 datë 19.05.2021 dhe lirim të menjëhershëm të ankuesit, në rast se nuk mbahej për shkaqe të tjera ligjore.

Sipas vërtetimit të paraqitur nga ankuesi, dokument i lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, KMCAP Niveli i Parë Neurologji-N/Kirurgji, ankuesi me vendimin nr.914, datë 27.10.2020 të

KMCAP për vlerësimin e PAK, është vlerësuar si person me aftësi të kufizuara, i grupit të dytë, nga data 01.05.2020 deri në datën 01.05.2022.

Ankuesi ka depozituar ankesën pranë Komisionerit duke pretenduar se ndihet i diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes ekonomike, pasi është dënuar dy herë për të njëjtën vepër penale dhe duke pretenduar përgjegjës për sjelljen diskriminuese G.M, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i cili ka qenë prokurori i i cili ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit për vendimin penal dhe N.M, Oficer i Policisë Gjyqësore, pranë Komisarariatit të Policisë Fier, i cili ka kryer ekzekutimin e vendimit, sipas urdhrit të ekzekutimit të prokurorit të çështjes.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose **është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji**; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja e vendimit për sjelljen diskriminuese”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari: Në rastin objekt shqyrtimi ankuesi K.H, pretendon se i janë shkelur të drejtat duke u dënuar dy herë për të njëjtën vepër penale.

Bazuar në nenin 34, të Kushtetutës së Shqipërisë, përcaktohet : “ Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohe sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj”. E drejta për të mos gjykuar ose dënuar dy herë për të njëjtën vepër penale parashikohet edhe nga neni 4, i Protokollit Nr.7 të KEDNJ-së : “1. Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksioni i të njëjtit Shtet për një vepër për të cilën ai më parë ka qenë shpallur i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij Shteti. 2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit të interesuar, në rast se fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, ose një mangësi themelore në procedimet e mëparshme janë të një natyre të tillë që mund të cenojnë vendimin e dhënë. 3. Asnjë derogim nuk lejohet për këtë nen në përputhje me nenin 15 të Konventës.”

Referuar fakteve të parashtruara dhe akteve të administruara, Komisioneri konstaton se, ankuesi nuk rezulton të jetë gjykuar ose dënuar dy herë për të njëjtën vepër penale. Pretendimet e ankuesit për shkeljen e të drejtave të tij burojnë nga procedurat e ekzekutimit të ndjekura nga prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore për ekzekutimin e vendimit penal në ngarkim të tij, me

të cilin ai është dënua me 6 muaj burgim, por ndërkohë pretendohet se këtë dënim me burgim ta ketë vuajtur gjatë kohës që ka qenë në paraburgim.

Bazuar në nenin 7, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, parashikohet se, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, dhe garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Prokuroria, ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Policisë Gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të caktuara me ligj. Prokuroria, i ushtron funksionet e saj në mënyrë të pavarur nëpërmjet prokurorëve.¹ Për ekzekutimin e një vendimi me burgim, prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit.² Urdhri i ekzekutimit, është akti procedural që nxjerr prokurori për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor penal.³

Prokurorët, janë autoritete publike, të cilët, në emër të shoqërisë dhe interesit publik, garantojnë zbatimin e ligjit, kur shkelja e ligjit mbart një sanksion penal, duke mbajtur njëkohësisht në konsideratë të drejtat e individëve dhe efektiviteti i nevojshëm i sistemit të drejtësisë penale.⁴ Megjithatë prokurori është një autoritet publik, në çështjen objekt shqyrtimi, prokurori kundër të cilit është depozituar ankesa, është duke ushtruar funksione procedurale penale. Urdhri i ekzekutimit i nxjerrë nga prokurori përbën një akt procedural në kuadër të të drejtës penale dhe jo një akt administrativ.

Komisioneri, është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit. Bazuar në kompetencat e dhëna nga ligji nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri ushtron funksioneve publike administrative, të rregulluara nga e drejta administrative. Në këtë kontekst, Komisioneri, pjesë e juridiksionit administrative, nuk mund të ushtroj kontroll mbi funksionet dhe aktet procedurale penale.

Në çështjen objekt shqyrtimi, rezulton se N.M, me detyrë Oficeri i Policisë Gjyqësore, ka ushtruar funksione procedurale në kuadër të detyrave dhe autorizimit nga ana e prokurorit dhe jo funksione me natyrë administrative. Komisioneri vlerëson se, edhe në këtë rast, sikurse për aktet

¹ Neni 148, i Kushtetutës së Shqipërisë, Neni 24, i Kodit të Procedurës Penale; Neni 3, i ligjit nr.97/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*”

² Neni 464 Kodi i Procedurës Penale

³ Neni 12, i ligjit nr.79 /2020 “ *Për ekzekutimin e vendimeve penale*”

⁴ Rekomandimin Rec(2000)19 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi rolin e prokurorisë publike në sistemin e drejtësisë penale.

e nxjerra nga Prokurori G.M, Komisioneri nuk mund të marrë në shqyrtim dhe të ushtrojë kontroll administrativ mbi aktet e mbajtura nga ana e N.M, pasi këto akte janë mbajtur në ushtrim të funksioneve procedurale penale të deleguara nga prokurori.

Kodi i Procedurës Penale, në nenin 470, përcakton, se, është gjykata organi kompetent për të ushtruar kontrollin procedural për ekzekutimin e vendimeve.

Së dyti: Në thelb ankuesi pretendon se veprimet e kryera nga subjektet kundër të cilëve ka paraqitur ankesën, prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore, gjatë ekzekutimit të vendimit penal në ngarkim të tij, kanë cënuar të drejtën e tij, duke bërë që ai të vuajë dy herë dënimin e dhënë sipas vendimit gjyqësor penal. Ankuesi pretendon se, sjellja e këtyre subjekteve e kanë diskriminuar atë për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjëndjes ekonomike.

Rezulton nga aktet e administruara se ankuesi është vlerësuar si person me aftësi të kufizuara bazuar në vendimin nr.914, datë 27.10.2020 të KMCAP⁵, urdhri i ekzekutimit të këtij vendimi nga ana e prokurorit ka dalë në datë 19.05.2021 ndërsa ekzekutimi i vendimit nga ana e oficerit të policisë gjyqësore është kryer në datën 18.06.2021. Në lidhje me këtë shkak, ankuesi pretendon se si pasojë e të drejtave të shkelura ndihet i diskriminuar pasi dëmi moral dhe psikologjik i shkaktuar i ka sjellë probleme të shëndetit të tij mendor. Në lidhje me shkakun e gjendjes ekonomike ankuesi, e pretendon por nuk ka depozituar asnjë akt provues në lidhje me gjendjen ekonomike.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjkata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjkata është shprehur se : *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me

⁵ Diagnoza e shënuar në vërtetimin e lëshuar nga KMCAP nuk është e kuptueshme, por sipas akteve të tjera që shoqërojnë ankesën , ankuesi është rekomanduar për kontroll për “*çrregullim bipolar me tipare psikotike*”.

të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të ndrejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqet e pretenduara nga ankuesi, aftësinë e kufizuar dhe gjendjen ekonomike, duke sanksionuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Sipas ligjit, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma, ndër të cilat, në formën e “Diskriminimit i drejtëpërdrejtë”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2) ose në formën e “Diskriminimit të tërthortë” e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7). Ndërkohë, sipas nenit 6, të ligjit, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të

marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit*, *kufizimit*, *përfjashtimit* ose *preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohej vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Duke mbajtur në konsideratë standartet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, ankuesi nuk ka ngritur pretendime për diferencë në trajtim ose për dështimin e subjekteve kundër të cilëve ka paraqitur ankesën për të trajtuar ndryshe rastin e tij, për shkak të situatës në të cilën ai gjendet, situatë e cila supozohet se ka si bazë aftësinë e kufizuar dhe gjendjen ekonomike.

Për shkakun e gjendjes ekonomike, ankuesi nuk ka dhënë asnjë sqarim dhe nuk ka depozituar asnjë provë për të vërtetuar ekzistencën e këtij shkakut. Minimalisht ankuesi ka detyrimin që të provojë shkakun e pretenduar prej tij, dhe në këto kushte Komisioneri vlerëson se shkakun e gjendjes ekonomike, mbetet i pavërtetuar. Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person është me aftësi të kufizuara, nuk mjafton për të ngjitur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar, por jo vetëm, duhet të paraqesë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur, që në çështjen objekt shqyrtimi është aftësia e kufizuar.

Komisioneri vlerëson se, në thelb ankuesi ka ngritur pretendime për paligjshmëri të veprimeve në ngarkim të tij nga ana e G.M, me detyrë Prokuror dhe N.M, me detyrë Oficer i Policisë Gjyqësore. Ankuesi pretendon se, për shkak të shkeljes së të drejtës së tij atij i kanë ardhur pasoja në shëndetin e tij mendor. Komisioneri nuk i hyn vlerësimit të veprimeve ose mosveprimeve të këtyre dy subjekteve, por bazuar në shpjegimet e ankuesit nuk rezulton të ketë ndonjë *dallim*, *përfjashtim*, *kufizim*, që bazohet në gjendjen ekonomike dhe aftësinë e kufizuar. Pretendimet e ankuesit nuk paraqesin elementë të trajtimit diferencues. Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Në lidhje me kompensimin për dëmin e pësuar, si pasojë e pretendimit për burgim të padrejtë, Komisioneri dëshiron të sjellë në vëmendje se kuadri ligjor në fuqi njeh të drejtën e kompensimit për burgim të padrejtë, sipas dispozitave të ligjit nr.9381, datë 28.4.2005 “*Për Kompensimin e Burgimit të Padrejtë*”. Sipas nenit 2, të këtij ligji, personi, që është deklaruar i pafajshëm ose për të cilin është pushuar çështja me vendim gjykatë të formës së prerë apo të prokurorit, ose është mbajtur në burg tej kohës së caktuar në vendimin e dënimit, gëzon të drejtën e kompensimit për burgimin e vuajtur.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesi K.H kundër G.M, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe N.M, Oficer i Policisë Gjyqësore, pranë Komisarariatit të Policisë Fier, nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “b” të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 196 regj., datë 01.11.2021, të paraqitur nga ankuesi K.H kundër G.M, Prokuror në prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe N.M, Oficer i Policisë Gjyqësore, pranë Komisarariatit të Policisë Fier.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku : Aftësia e kufizuar, gjendja ekonomike
Fusha : Shërbime
Lloji i vendimit: Mospranim